

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6485
E enjte, 9 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Olaf Scholz merr drejtimin e Gjermanisë

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ANALISTËT I KANË KOMENTUAR DEKLARATAT E PËRFAQËSUESIT TË LARTË TË BASHKIMIT EVROPIAN, JOSEP BORRELL, PËR ASOCIACIONIN I FAQE 4-5

ANALISTËT: DO TË RRITET PRESIONI NDËRKOMBËTAR PËR DIALOGUN

OPINION

KOSOVA NË DUAR TË MAFIAS ENERGETIKE F. 6

Shkruan:
Ramush
HARADINAJ



AKTUALE



KOMANDANTI I FSK-së I NJOFTON ZYRTARËT E NATO-S ME TË ARRITURAT E KËSAJ FORCE F. 5

IMPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE GJATË MUAJIT NËNTOR KA KUSHTUAR RRETH 10 MILIONË EURO F. 6

EKONOMI



TË HËNËN SEANCA E RADHËS, DO TË DISKUTOHET PËR LIGJIN E PAGAVE F. 8

ZKA-JA: KOMUNAT DUHET T'I KUSHTOJNË VËMENDJE MË TË MADHE MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE F. 8

SPORT

GRANIT RUGOVA, U. D. I DREJTORIT EKZEKUTIV I LIGËS UNIKE F. 24



Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije se ndërkombëtarët do ta shtojnë presionin ndaj Kosovës për dialogun me Serbinë. Ata kanë bërë me dije se presioni i Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të koncentrohet në zbatimin e marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, kryeministri Albin Kurti tani ose duhet t'i marrë parasysh qëndrimet e ndërkombëtarëve për këtë çështje ose t'u mbetet besnik qëndrimeve të tij për moszbatimin e marrëveshjes së asociacionit

Gucati: Nuk kam thënë se dëshmitarët që kanë qenë kundër UÇK-së janë vrarë I FAQE 7



FILLON DHËNIA E DOZËS SË TRETË TË VAKSINËS KUNDËR COVIDIT NË KOSOVË



Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se nga sot (e enjte) do të jepet edhe doza e tretë përforcuese e vaksinës kundër Covid-19 në Kosovë. Doza përforcuese u jepet personave të cilët i kanë

marrë dy doza të vaksinës kundër Covid-19, tek të cilët, me kalimin e kohës, imuniteti i tyre ka rënë. Sipas MSh-së, doza përforcuese jepet gjashtë muaj pas marrjes së dozës së dytë I FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Olaf Scholz merr drejtimin e Gjermanisë

BERLIN, 8 DHJETOR - Olaf Scholz u emërua kancelar i Gjermanisë dhe do të drejtojë një koalicion të qendrës së majtë. Në këtë pozitë Scholz pason Angela Merkelin, e cila për 16 vjet udhëhoqi Gjermaninë.

Scholz, 63 vjeç, më 8 dhjetor u zgjedh kancelar me mandat katërvjeçar nga Bundestagu dhe më pas u betua para presidentit gjerman Frank-Walter Steinmeier.

Kancelari i ri i Gjermanisë udhëhoqi Socialdemokratët (SPD) drejt fitores në zgjedhjet e 26 shtatorit, duke dërguar në opozitë, për herë të parë pas 16 vjetësh, Demokristianët e Merkelit.

Gjatë kohës sa Merkel ishte kancelare, Scholz ka shërbyer në kabinetin e saj në postin e ministrit të Financave dhe atë të zëvendëskancelarit.

Merkel, 67 vjeçe, nuk garoi në zgjedhjet e fundit dhe po

tërhiqet nga politika pas katër mandateve radhazi si kancelare e Gjermanisë.

Koalicioni qeverisës përbëhet nga SPD-ja, ambientalistët e Gjelbër dhe partia pro-biznesit, Demokratët e Lirë.

Pavarësisht prej dallimeve ideologjike dhe politike, qeveria e re ka për qëllim ta përshpejtojë digjitalizimin, ta bëjë ekonominë e gjelbër, ta adresojë çështjen e çmimeve të papërbalueshme të banimit, ta heqë pagën minimale dhe ta legalizojë marijuanën.

Qeveria, po ashtu, planifikon t'i rishikojë ligjet e migracionit dhe shtetësisë, duke lejuar shtetësinë e dyfishtë dhe për ta thjeshtuar procesin e marrjes së pasaportës gjermane. Për më tepër, azilkërkuessve që do të integrohen në shoqëri do t'u jepet mundësia që të qëndrojnë përgjithmonë në

Gjermani dhe bashkimi familjar për refugjatët do të zgjerohet.

Sipas marrëveshjes, partnerët e koalicionit planifikojnë që të vendosin deri më 2023 rregullin që Gjermania të mos krijojë borxhe të reja.

Lufta kundër pandemisë pritet të dominojë në ditët e para të qeverisë, teksa infektimet e reja janë rritur. "Ne duhet t'ia nisim nga e para teksa do të përballemi me pandeminë. Këto janë rrethanat me të cilat do të përballlet qeveria e re", pati deklaruar Scholz më 6 dhjetor.

Ai mbështet bërjen e detyrueshme të vaksinimit për të gjithë gjermanët prej shkurtit të vitit të ardhshëm, nëse ky ligj kalon në Bundestag. Aktualisht, 68,5 për qind e popullsisë në Gjermani është e vaksinuar plotësisht.



ShBA-ja miraton projektligjin për financimin e Ushtrisë së Ukrainës

WASHINGTON, 8 DHJETOR - Dhoma e Përfaqësuesve e Shteteve të Bashkuara ka miratuar një projektligj të mbrojtjes në vlerë prej 770 miliardë dollarësh për furnizimin e ushtrisë ukrainase, stabilitetin e Baltikut dhe luftimin e ndikimit kinez.

Projektligji u miratua në mbledhjen e 7 dhjetorit dhe pati mbështetje të dy partive. Ky legjislacion pritet të miratohet më vonë gjatë kësaj jave edhe në Senatin amerikan. Demokratët kontrollojnë edhe Dhomën e Përfaqësuesve dhe Senatin dhe pasi të miratohet nga të dyja dhomat, ky projektligj pritet të



nënshkruhet nga presidenti Joe Biden, në mënyrë që të shndërrohet në ligj. Projektligji autorizon 25

miliardë dollarë shtesë, sipas kërkesës së presidentit Biden dhe do ta lejojë rritjen e buxhetit për ushtrinë për 5 për qind, por ky legjislacion anashkalon një propozim për të vendosur sanksione mbi gazsjellësin rus "Rrjedha Veriore 2".

Ligjvënësit, po ashtu, hoqën dorë nga një amendament që kishte për qëllim ndalimin e shtetasve amerikanë ta blinin borxhin sovran rus.

Ushtria e Ukrainës do të marrë 300 milionë nën Iniciativën e Mbështetjes së Sigurisë së Ukrainës, ndërkaq 4 miliardë dollarë janë dedikuar për Iniciativën për Mbrojtje

Evropiane dhe 150 milionë dollarë për bashkëpunimin e sigurisë në Baltik.

Ky projektligj ka për cak Kinën me 7.1 miliardë dollarë të ndara për Iniciativën e Paqësorisht për Parandalim të një deklarate nga Kongresi për mbrojtjen e Tajvanit dhe një ndalesë nga Departamenti i Mbrojtjes për të mos blerë prodhime të prodhuara në rajonin kinez, Ksinjiang. ShBA-ja thotë se Kina po kryen gjenocid ndaj ujgurëve dhe minoriteteve të tjera myslimane në rajonin e Ksinjiangut, ku dy milionë persona janë dërguar në kampe të ndalimit.

Pfizer/BioNTech: Tri doza të vaksinës janë efektive kundër 'Omicronit'

NYU-JORK, 8 DHJETOR - Kompanitë "Pfizer" dhe "BioNTech" njoftuan më 8 dhjetor se tri doza të vaksinës së këtij prodhuesi kundër Covid-19, treguan që gjenerojnë efekte neutralizuese kundër variantit të ri të koronavirusit, "Omicron".

Ky përfundim u nxor pas testeve intensive që kompania bëri në laborator. Në njoftimin e parë zyrtar nga prodhuesi i vaksinës lidhur me

efikasitetin e vaksinës së saj kundër "Omicronit", "BioNTech" dhe "Pfizer", njoftuan se dy doza të vaksinës rezultuan që kanë më pak efekt për neutralizimin e antitropave, por me dozën e tretë të vaksinës vërehet rritja e efikasitetit.

Rezultatet janë preliminare derisa gjetjet janë përshkruar vetëm në një komunikatë për medie. Më shumë të dhëna ende nuk janë të qasshme.

Kompania shtoi se nëse është e nevojshme, vaksinat që do të kishin për bazë variantin "Omicron" do të mund të ishin gati deri në mars 2022.

Organizata Botërore e Shëndetësisë njoftoi se vaksinat mbrojnë njerëzit nga varianti "Omicron". Sipas doktorit Mike Ryan nga OBSh-ja, të dhënat e para dëshmojnë se "Omicron"-i nuk i bënë njerëzit më të sëmurë sesa "Delta" apo variantet e tjera.



Fillon dhënia e dozës së tretë të vaksinës kundër Covidit në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se nga sot (e enjte) do të jepet edhe doza e tretë përforcuese e vaksinës kundër Covid-19 në Kosovë. Doza përforcuese u jepet personave të cilët i kanë marrë dy doza të vaksinës kundër Covid-19, tek të cilët, me kalimin e kohës, imuniteti i tyre ka rënë. Sipas MSh-së, doza përforcuese jepet gjashtë muaj pas marrjes së dozës së dytë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Komiteti për imunizim të popullatës me vaksinën kundër Covid-19, në takimin e mbajtur së fundmi, në funksion të zbatimit të planit të përditësuar për vaksinimin në masë të qytetarëve me vaksinën kundër Covid-19, ka vendosur që duke filluar nga sot (e enjte), të fillohet me administrimin e dozës përforcuese dhe dozës së tretë të vaksinës kundër Covid-19 në popullatë. Kështu ka bërë me dije, me anë të një komunikate për medie, Ministria e Shëndetësisë.

Kjo ministri ka njoftuar se doza përforcuese u jepet personave të cilët i kanë marrë dy doza të vaksinës kundër Covid-19, por tek të cilët, me kalimin e kohës, imuniteti i tyre ka rënë. Sipas MSh-së, doza përforcuese jepet 6 muaj pas marrjes së dozës së dytë. "Doza e tretë u jepet personave të cilët i kanë marrë dy dozat e vaksinës kundër Covid-19, por tek të cilët nuk është zhvilluar imuniteti i duhur si pasojë e imunitetit të dobët të tyre apo sëmundjeve shoqëruese me rekomandim të mjekut ordinues. Doza e tretë jepet jo më herët se 8 javë dhe pa i bërë 6 muaj nga marrja e dozës së dytë. Dozën përforcuese dhe dozën e tretë mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare sipas intervaleve kohore për dozat e lartcekura", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

Kjo ministri ka treguar se qytetarët do të njoftohen për datat e vaksinimit përmes sms-

ve, e-mailit dhe njoftimeve publike. Duke konsideruar që vaksinimi është mënyra më efektive për ta kufizuar dhe ndërprerë përhapjen e virusit dhe për ta arritur mbrojtjen e popullatës, Ministria e Shëndetësisë u bënë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i shfrytëzojnë qendrat dhe ekipet mobile të vaksinimit kudo në Kosovë për t'u vaksinuar sa më parë kundër Covid-19.

Me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe mbrojtjes nga Covid-19, Qeveria e Kosovës ka miratuar këto ditë masat e reja kundër këtij virusi. Sipas raporteve të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, situata epidemiologjike me Covid-19 në Kosovë është stabile, por rreziku mbetet sepse varianti "Delta" vazhdon të jetë dominues te ne, shfaqja e rasteve me variantin "Delta plus" dhe se në vendet e tjera në rajon dhe botë ka përqendrim të ndjeshëm të situatës



epidemiologjike, ndërkohë që OBSH-ja ka njoftuar për shfaqjen e variantit të ri të quajtur "Omicron" si variant shqetësues ku kërkohet vigjilencë e shtuar në mbikëqyrjen epidemiologjike si dhe zbatimin e masave si vaksinimi dhe masave jofarmaceutike për ta parandaluar përhapjen e Covid-19.

Sipas masave të reja, qytetarët

që do të hyjnë në Kosovë duhet të kenë dëshminë e vaksinimit të plotë, të testeve negative apo dëshmisë se e kanë kaluar koronavirusin. Po ashtu, kërkohet nga të gjithë personat që do të hyjnë në Kosovë, pas datës 3 janar 2022, të kenë dëshmi të vaksinimit të plotë, ose një dozë të vaksinës bashkë me test negativ PCR, ose një dozë të vaksinës me dëshminë e kalimit të sëmundjes.

Shtetasve të Kosovës dhe atyre me qëndrim të përkohshëm, me masat e reja, u jepet "mundësia të vaksinohen nga ekipet mobile të vendosura në pikat kufitare" tokësore, por edhe në aeroportin "Adem Jashari". Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, bëri thirrje për vaksinim të qytetarëve si masë mbrojtëse kundër koronavirusit. Ai njoftoi se procesi i vaksinimit po realizohet edhe gjatë fundjavës. "Për ta evituar mbingarkesën spitalore, mbyllet e shkollave dhe ekonomisë, udhëtarëve që shërbehen me transportin publik dhe privat do t'u kërkohen dëshmi si vaksinimi i

plotë apo i pjesshëm dhe bashkë me të, shërimi apo rezultati negativ i virusit", ka thënë ministri Latifi në një konferencë për media.

Nga paraqitja e dëshmimeve për vaksinim apo testeve për Covid-19, sipas masave të reja, do të përjashtohen personat që kalojnë transit nëpër Kosovë, personat nën 12 vjeç si dhe ata që kanë dëshmi mjekësore se nuk mund të vaksinohen.

Dëshmia e vaksinimit të plotë, po ashtu, do të kërkohet edhe nga personat që përdorin transportin publik.

Mbajtja e maskës vazhdon të jetë obliguese. Sipas masave, kufizimi i lëvizjes do të vazhdojë të jetë në fuqi nga mesnata deri në orën 05:00.

Ndërkaq, as orari i gastronomisë nuk ka ndryshuar, sektor i cili lejohet të punojë deri në orën 23:00, ndërkaq muzika ndalohej pas orës 21:30.

Klubet e natës dhe organizimi i ahengjeve vazhdon të jetë i ndaluar, thuhet në vendimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me masat për pandeminë.

Asnjë i vdekur dhe dhjetë raste të reja me Covid-19 në 24 orë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të mërkurën se janë regjistruar edhe dhjetë raste të reja me Covid-19. Rastet e reja dolën pas testimit të 2 288 mostrave. Sipas raportit, në 24 orët paraprake janë shëruar edhe pesë pacientë. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në Kosovë aktualisht janë 319 raste aktive me Covid. Sa i përket vaksinimit, brenda 24 orëve janë dhënë 3 236 vakcina kundër koronavirusit. Deri më 8 dhjetor 768 814 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Që nga fillimi i fushatës së vaksinimit në Kosovë në muajin mars, në gjithë vendin janë dhënë 1 633 364 doza të vaksinës.

Gashi nis mandatin e tretë në krye të Obiliqit: Kryefjalë do të jetë qytetari

OBILIQ, 8 DHJETOR (ER) - Kuvendi Komunal i Obiliqit ka mbajtur mbledhjen inauguruese, në të cilën janë betuar kryetari dhe 21 asamblistët e rinj. Xhafer Gashi nga Iniciativa Qytetare, i cili ka udhëhequr dy mandate me Obiliqin, ka thënë se prioritet i qeverisjes së tij në mandatin e tretë mbetën arsimit dhe shëndetësia. Para asamblistëve dhe të

ftuarve të tjerë në ceremoninë solemne të marrjes së detyrës, Gashi ka thënë se kryefjalë e qeverisjes së tij edhe për një mandat tjetër do të jenë qytetarët. "Ky mandat do të jetë vazhdim i përkushtimit, punës, vullnetit, angazhimit të pandalshëm për t'i përmbushur kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Plani ynë është i qartë, qytetari i Obiliqit

do të jetë kryefjalë e çdo zhvillimi. Bashkë me qytetarët do të zhvillojmë projekte, bashkë do t'i mbikëqyrim dhe bashkë do t'i gëzojmë ato. Shërbimet efikase administrative, transparencë dhe llogaridhënie, janë jo vetëm betim, por edhe obligim yni kryesor karshi bashkëqytetarëve tanë", ka thënë Gashi.





ANALISTËT I KANË KOMENTUAR DEKLARATAT E PËRFAQËSUESIT TË LARTË TË BASHKIMIT EVROPIAN, JOSEP BORRELL, PËR ASOCIACIONIN

Analistët: Do të rritet presioni ndërkombëtar për dialogun

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije se ndërkombëtarët do ta shtojnë presionin ndaj Kosovës për dialogun me Serbinë. Ata kanë bërë me dije se presioni i Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të koncentrohet në zbatimin e marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, kryeministri Albin Kurti tani ose duhet t'i marrë parasysh qëndrimet e ndërkombëtarëve për këtë çështje ose t'u mbetet besnik qëndrimeve të tij për moszbatimin e marrëveshjes së asociacionit

kryeministrin Kurti do të rritet për të marrë vendime të vështira në kuadër të dialogut", ka shkruar Shasha. Sipas tij, tani kryeministri Albin Kurti është në një udhëkryq. "Është e qartë se i vjen fundi atij narracioni. 'dialogu është prioritet i katërt', 'duhet të bëhet dialog me serbët lokalë', 'CEFTA duhet të zëvendësohet me SEFTA' etj. Tanimë është e qartë se asnjë nga këto qëndrime nuk e ka mbështetjen e BE-së apo të ShBA-së. Siç duket, kryeministri Kurti është në udhëkryq. Me një anë ai mund ta zgjedhë rrugën e lehtë dhe të bëhet 'i favorizuar i ndërkombëtarëve', duke u thënë 'po' kërkesave të tyre. Apo ai mund ta zgjedhë rrugën e vështirë dhe t'u qëndrojë besnik bindjeve të tij dhe aleancës që ka bërë me qytetarët", ka shkruar Shasha. Kurse Violeta Haxholli, hulumtuuese në KDI, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se BE-ja do ta vazhdojë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në këtë proces. "Përfaqësuesit e BE-së po vazhdojnë ta

ripërsëritin qëndrimin e tyre lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të dialogut, me theks të veçantë atë për asociacionin. Kjo është e natyrshme duke pasur parasysh rolin e BE-së si lehtësuese e këtij procesi. Prandaj, sigurisht se ata duan që t'i shohin këto marrëveshje duke u zbatuar", ka thënë Haxholli. Ajo ka paralajmëruar se edhe në të ardhmen do të ketë vështirësi në procesin e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit. "Sa i përket të ardhmes së procesit të dialogut, është vështirë të parashikohet diçka konkrete meqë me ndërrimin e qeverisjes në Kosovë ka ndërruar qasja ndaj dialogut dhe marrëveshjeve të arritura më herët. Në anën tjetër, as Serbia nuk i ka zbatuar shumë marrëveshje. Mund të thuhet që mungon vullneti politik nga të dyja anët qoftë për të lëvizur përpara dialogun apo për t'i zbatuar marrëveshjet e kaluara. Fakti që është dashur të diskutohen sërish temat si liria e lëvizjes/targat e veturave tregon për

vështirësitë e zbatimit të marrëveshjeve të mëhershme", ka deklaruar ajo, duke shtuar se vështirë se Qeveria e Kosovës do të lëvizë nga pozicioni aktual. "Sa i përket marrëveshjes për asociacionin, qeveria e ka ripërsëritur disa herë se nuk do ta zbatojë, ndërsa ka kërkuar që ky mekanizëm të zëvendësohet me një këshill nacional ashtu si është në Serbi. Prandaj, vështirë që do të ketë lëvizje nga ky pozicion", është shprehur Haxholli. Një ditë më parë, në konferencën e përbashkët për medie me kryeministrin Albin Kurti, shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, ka insistuar që Kosova duhet ta zbatojë marrëveshjen për asociacionin. "Nuk pajtohem që Gjykata Kushtetuese (e Kosovës) vendosi pengesa për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Por, kjo (marrëveshje) u arrit ndërmjet përfaqësuesve të dy qeverive dhe në kuadër të dialogut. Kështu që, më vjen keq, por na duhet të kërkojmë zbatimin e kësaj marrëveshjeje", ka deklaruar Borrell.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

Prishtinë, 8 dhjetor - Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije se qëndrimi i fundit i shefit të diplomacisë evropiane, Josep Borrell, se Kosova duhet ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, tregon se do të rritet presioni ndërkombëtar për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ata kanë bërë me dije se BE-ja do të tregohet këmbëngulëse në këtë çështje. Drejtori ekzekutiv i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka bërë me dije se tani hendeuku në mes të Kosovës dhe BE-së për

çështjen e asociacionit të komunave me shumicë serbe është edhe publik.

Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se presioni ndërkombëtar mbi kryeministrin Kurti për këtë çështje do të rritet. "Hendeuku në mes të Kosovës dhe BE-së për çështjen e asociacionit tanimë është edhe publik. Përfaqësuesi i lartë, Borell, publikisht shprehi mospajtim me kryeministrin Kurti sa i përket obligimit të Kosovës për ngritjen e asociacionit. Në të njëjtën vijë me BE-në është edhe ShBA-ja. Pra, deri në, dhe me përfundimin e zgjedhjeve në Serbi në prill 2022, presioni ndërkombëtar mbi



Komandanti i FSK-së i njofton zyrtarët e NATO-s me të arriturat e kësaj force

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Në kuadër të vizitës zyrtare, shefja e operacioneve aktuale të Divizionit Operativ të Shtabit të Përgjithshëm të NATO-s, Ariella Viehe, u prit në takim nga komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Bashkim Jashari. Gjatë takimit Ariella Viehe u shoqërua edhe nga drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneralbrigade Jorg Ruter. Me këtë rast, gjeneral Jashari i ka dëshiruar mirëseardhje, duke i shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për kontributin e ekipit të NALT-it në të gjitha të arriturat e deritashme të FSK-së, duke theksuar se bashkëpunimi reciprok do të avancohet edhe më tej.

Gjeneral Jashari e ka njoftuar Viehen me vizionin e tij për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së nga pozita e komandantit të ri të FSK-së, duke vënë në fokus arritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat e vendeve anëtare të NATO-s. Ai ka shprehur vullnetin e tij që



Kosova nga vend konsumues i sigurisë, t'i mundësohet ofrimi i kontributit në operacione të përbashkëta me vendet anëtare dhe partnere të NATO-s, për çka është dëshmuar dhe po dëshmohet suksesshëm edhe me mbështetjen në operacionin aktual humanitar të NATO-s për evakuimin e

refugjatëve afganë.

Nga ana e saj, Viehe ka falënderuar gjeneral Jasharin për pritjen dhe e ka uruar për marrjen e detyrës së komandantit të FSK-së, duke shprehur impresionet e saj të larta me vizionin e gjeneral Jasharit për të ardhmen e FSK-së dhe bashkëpunimit me

NALT-in dhe KFOR-in.

Ai, gjithashtu, theksoi se përvoja e gjatë e gjeneral Jasharit si lider ushtarak, posaçërisht në detyrën e mëparshme si inspektor gjeneral i FSK-së, është shumë me rëndësi për eliminimin e sfidave dhe rrugëtimin e suksesshëm përpara drejt

përbushjes së vizionit të qartë dhe objektivave të tij operacionale.

Në fund që të dy, vizitën e Viehes dhe takimet e këtij niveli në këtë periudhë, i vlerësuan me rëndësi të veçantë për proceset zhvillimore nëpër të cilat aktualisht po kalon Forca e Sigurisë e Kosovës.

Bota ka filluar operacionet me robotë, ne ende kemi lista të pritjes për operim

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Cilësia e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë dhe strategjia kombëtare për ruajtjen e funksionalitetit të sistemit shëndetësor të Kosovës ishte temë diskutimi ndërmjet krerëve të sistemit shëndetësor dhe Fakultetit të Mjekësisë. Aty u tha se rëndësia e përgatitjes në aspektin shkollor ndikon pozitivisht në të ardhmen e sistemit shëndetësor.

Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka thënë se synim i tyre është ruajtja e trurit shkencor, duke shtuar se duhet që studentët të përgatiten më mirë në mënyrë që në të ardhmen të kemi mjekë të mirë. "Që nga dita kur e kam

pranuar detyrën e ministrit kam vepruar për tri çështje të rëndësishme. E para, ne duhet ta ruajmë mendjen dhe trurin shkencor. E dyta, është që atë që e kemi këtu ta ruajmë. Për mua është paradoksale që kemi investuar për krijimin e njerëzve tanë që na edukojnë, e kur i bëjnë 65 vjeç, u themi faleminderit, pra është një formë që po e largojmë trurin tonë. Duhet t'i përgatitim studentët më mirë në mënyrë që në të ardhmen të kemi mjekë të mirë", ka thënë Latifi. Ministri Latifi ka thënë se bota ka filluar operacionet me robotë, ndërsa në Kosovë ende janë listat e pritjes të pacientëve për të hyrë në operim.



Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka vazhduar të insistojë se kjo marrëveshje është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. "Janë 33 marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Dy të tretat e tyre s'janë zbatuar nga Serbia, por gjithmonë Beogradi zyrtar

dëshiron ta përmendë një marrëveshje që më duhet ta them s'e ka kaluar testin e Gjykatës sonë Kushtetuese. Më kujtohet më 2015, kur në vendimin e saj asnjë serb i Kosovës nuk protestoi, por vetëm Beogradi. Besoj se është koha që të ketë dialog, ku

populli, qytetarët, janë përfituesit e jo politikanët. Prandaj na duhet karakter demokratik i dialogut që të fitojnë njerëzit. Ritheksoj se në fund të dhjetorit të 2015-s serbët nuk u brengosën fort për vendimin e Kushtetueses, por ishte Beogradi që po

vajtonte për atë që ka ndodhur", ka thënë Kurti. Deri më tani, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar dy herë me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Takimi i tyre

i fundit është zhvilluar më 19 korrik, por palët nuk arritën ndonjë rezultat konkret. Më herët është paralajmëruar edhe një takim i tretë në mes të Kurtit dhe Vuçiqit, por së fundi zyrtarët evropianë kanë treguar se një takim i tillë nuk pritet të ndodhë.

Importi i energjisë elektrike gjatë muajit nëntor ka kushtuar rreth 10 milionë euro

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) ka njoftuar se kostoja e energjisë elektrike është rritur për shkak të rritjes së çmimeve të saj në tregun ndërkombëtar përtej çdo parashikimi. "Ato kanë prekur edhe vendet më të zhvilluara të Evropës. Ballafaqimi me çmimet e larta të importit të energjisë elektrike duhet të bëjë që secili nga ne të reflektojmë përballë kësaj krize. E gjithë kjo në mënyrë që efekti negativ i tyre të ndihet sa më pak në të ardhmen. Thirrjet tona për kursim po bëhen me qëllim që t'u lehtësohet barra financiare konsumatorëve tanë në faturat mujore në këtë periudhë, por edhe në të ardhmen. Në anën tjetër, tani që sfida e sigurimit të importit me çmime të larta po bëhet edhe më e madhe për KEDS-in dhe KESCO-n, thirrja

për kursim dhe përkrahja e konsumatorëve, së bashku me mbështetjen e institucioneve, është e domosdoshme", ka njoftuar KEDS-i. Sipas këtij njoftimi, dihet se për plotësimin e kërkesës për energji elektrike importi i energjisë elektrike në orë të caktuara ka qenë gjithmonë i pashmangshëm, por në krahasim me vitin e kaluar, kur çmimi i importit të energjisë elektrike për muajin nëntor ka qenë 2.3 milionë euro, këtë vit kjo shumë ka shënuar rritje deri në 10 milionë euro. "Rritja e shpejtë e çmimeve të importit në këtë nivel ishte e paparashikueshme nga të gjithë politikëbërësit. Kjo shumë e lartë as për së afërmi nuk është paraparë nga askush, brenda dhe jashtë kufijve, dhe ka ardhur si pasojë e shumë faktorëve, kontrolli i të cilëve është jashtë vullnetit dhe ndikimit tonë. Me



rënien e temperaturave nën zero, kërkesa do të jetë edhe më e madhe për import të energjisë. Nëse e shohim edhe nga ana tjetër, trendet e çmimeve,

sidomos në kohë të pikut, janë duke u rritur. Prandaj, që sistemi të jetë në gjendje t'i përballojë ngarkesat nga faktorë të shumtë, qofshin për shkak të çmimeve të

papërbalueshme, ose nga konsumi i lartë i energjisë elektrike, kërkohet vëmendja dhe bashkëpunimi i të gjithëve", ka njoftuar KEDS-i.

Szunyog: S'ka asnjë marrëveshje në dialog që pengon vendosjen e policisë në veri



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Për shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, Kosova ka shënuar njëfarë përparimi në një disa fusha. Këtë, sipas tij, e thotë edhe raporti i fundit i Komisionit Evropian. "Kosova ka bërë përparim apo njëfarë përparimi: lufta kundër terrorizmit, ekonomia e tregut ose reformat strukturore; digjitalizimi i ekonomisë, përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, investimet në burimet e ripërtëritshme, doganat, taksat, politikat e ndërmarrjeve dhe ato industriale", ka përmendur ai fushat ku ka pasur ecje. "Përparimi i kufizuar, megjithatë, është përparim", ka deklaruar Szunyog. Szunyog për "Klan Kosova", duke përmendur fushat ku nuk ka pasur përparim, ka theksuar se raporti i fundit duhet të shihet si mundësi për veprime konkrete në periudhën pasuese njëvjeçare.

"Shpresojmë se vitin në vijim do të ketë më tepër vendime konkrete. Është me rëndësi të shikohet raporti si një grumbull rekomandimesh për hapa të mëtejshëm, një udhërrëfyes për veprime. Puna për raportin e ardhshëm nis që tani. Kosova mund të bëjë më mirë: qytetarët meritojnë më mirë", ka deklaruar Szunyog. Ai në disa përgjigje ka folur edhe për zhvillimet e muajve më parë në veri të Kosovës, duke potencuar se asnjë marrëveshje dialogu nuk ndalon Policinë e Kosovës vendosjen kudo në territorin shtetëror. Megjithatë, për pjesën veriore thotë se ka njëfarë tradite njoftimi. "Nuk ka asnjë marrëveshje në dialog që pengon vendosjen e njësisë speciale policore nga jugu në veri, por që është një praktikë e zakonshme koordinimi i ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare si dhe njoftimi paraprak i KFOR-it", ka theksuar Szunyog.

MPB-ja bën thirrje për kujdes gjatë përdorimit të fishekzjarrëve

PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Me rastin e festave të fundvitit, Ministria e Punëve të Brendshme u ka bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes gjatë festimeve me mjete piroteknike dhe mjete të tjera të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve. MPB-ja këshillon qytetarët që fishekzjarrët dhe mjetet e tjera piroteknike të përdoren vetëm nga të rriturit dhe këto mjete t'u shiten vetëm

personave të rritur. Shitja e fishekzjarrëve dhe mjeteve të tjera piroteknike është e lejuar prej datës 19 dhjetor deri më 31 dhjetor, ndërsa përdorimi i tyre lejohet prej datës 26 dhjetor deri më 2 janar. Me qëllim të ruajtjes së qetësisë publike dhe mbrojtjes së kalimtarëve të rastit, përdorimi i fishekzjarrëve është i ndaluar në rrugë publike, sheshe, vendbanime të

dendura me ndërtesa dhe në të gjitha hapësirat e mbyllura, në afërsi të spitaleve, si dhe në mjetet e transportit të udhëtarëve. Luten qytetarët që pas blerjes së mjeteve piroteknike, të sigurohen që këto mjete të mos dëmtohen dhe të vendosen në vende të sigurta larg fëmijëve, si dhe t'i përdorin sipas udhëzimeve të përdorimit", ka njoftuar MPB-ja.



Kosova në duar të mafias energjetike



Shkruan: Ramush HARADINAJ

As unë nuk e kam besuar që për një kohë aq të shkurtër të vinte në pah gabimi strategjik i qeverisë Kurti për anulimin e projektit Kosova e Re në maj të 2020-s i nënshkruar me kompaninë Amerikane Contour Global. Kur ne kemi nënshkruar

marrëveshjen në vitin 2017 për investim prej 1.3 miliard eurosh, ne kemi qenë të vetëdijshëm se thëngjilli nuk është e ardhmja e energjisë, por Kosova nuk ka pasur alternativë të shpejtë që ruan qytetarin, garanton zhvillim ekonomik dhe ruan pavarësinë energjetike të Kosovës. Ne nuk ishim vend aq i zhvilluar që me lehtësi dhe pavarësisht kostos së lartë, kalon në energji alternative me 500 MW që do të prodhoheshin dhe me 10 000 vende të reja të punës që do të krijoheshin. Ne kemi besuar se dëmet në ambient do të ishin të pranueshme, në raport me përfitimet që do të kishte Kosova.

Jam fyer dhe jam linçuar për atë se çmimi i energjisë i garantuar prej 80 euro MW është tejet i lartë dhe se ky çmim do të shkatërrojë ekonominë e Kosovës e lloj-lloj sharjesh të tjera. Të kota ishin sqarimet tona se të gjitha parashikimet ishin se çmimet e energjisë së vitit 2017 ishin të paqëndrueshme. Kam qenë i bindur se shpesh këto fushata kanë qenë të orkestruara dhe financuara nga mafia energjetike e cila meqenëse veç kishte gjetur strehë tek lëvizja Vetëvendosje me ndërtimin e kapaciteteve të reja do të humbiste një treg të madh siç është tregu i Kosovës. Sot zyrtarët e KEDS-it dhe

KOST-it në raportet e tyre thonë se: "KEDS dhe KESCO gjatë tetorit të këtij viti, pra, për një muaj, përkundër motit të mirë, ka importuar 9,15 milionë euro energji elektrike me çmim mesatar prej 242 eurosh megavat/orë kurse gati dyfishi i vlerës së tetorit është importuar me çmim prej 340 eurosh më 24 nëntor. Kërkesa është rritur me 200MW në krahasim me vitin e kaluar".

Nuk kam informacione si është në dhjetor, por e qartë që në momentin e parë që ashpërsohet moti, një Zot e di sa do të jetë çmimi dhe është pikëpyetje e madhe se a do të ketë Kosova mjete që të blejë energji me çmime astronomike.

KEDS dhe KESCO nuk kanë se si t'i shpëtojnë kolapsit nëse trendet aktuale vazhdojnë. Popullizmi dhe retorika boshe e qeverisë Kurti po shihet se i ka filluar goditjet e para për popullin e Kosovës dhe dëmet e vendimeve të gabuara strategjike për kohë të gjatë do t'i paguajë qytetari i Kosovës. Fatkeqësisht, edhe refuzimi i gazsjellësit amerikan, së fundmi, do të sjellë pasoja të paparashikueshme për pozitën energjetike të Kosovës dhe jo vetëm.

Me të drejtë shtrohet pyetja: Kush janë këta njerëz që rrezikojnë stabilitetin e çmimeve dhe pavarësinë energjetike të Kosovës?!

Gucati: Nuk kam thënë se dëshmitarët që kanë qenë kundër UÇK-së janë vrarë



HAGË, 8 DHJETOR (ER) - Edhe të mërkurën ka vazhduar procesi gjyqësor ndaj Hysni Gucatit në Gjykatën Speciale në Hagë. Gucati është acaruar ndaj panelit të pranishëm në këtë seancë lidhur me rrjedhjen e dokumentacioneve. "Më përpara kisha menduar të vdes pesë herë sesa të dalin këto dokumentacione tuaja e të vij në zyrat tona. Këto kush i ka bërë për me na qit neve në lajthitje, e dini më mirë se ne. Unë kam qenë aty dhe kam thirrur konferencën, por nuk kam shpërndarë (dokumente). Nëse kanë ardhur në Prishtinë nga Holanda, atëherë shpërndarja ka ndodhur nga ju, jo nga ne", ka deklaruar Gucati.

I pyetur nga prokurorja e specializuar, Valeria Bolici, se pse mendon se deklaratat e personave që i ka shpërndarë më 17 shtator janë gënjeshtra

dhe fabrikime, kryetari i organizatës së OVLUÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se UÇK-ja nuk ka pasur asnjë shanse teorike të kryejë ndonjë masakër apo vrasje. "UÇK-ja nuk ka pasur shanse teorike të bëjë asnjë masakër, asnjë vrasje ndaj qytetarëve serbë, apo ndaj dikujt. Këtë e dinë mirë edhe forcat e NATO-s dhe të gjithë ndërkombëtarët se UÇK-ja nuk ka pasur teori, as praktikë e forcë që të bëjë një gjë të tillë", është shprehur Gucati.

Prokurorja Bolici ka paraqitur disa shkrime të Gucatit në faqen e tij në 'Facebook' dhe intervista të cilat i ka dhënë më herët në mediat në Kosovë që, sipas saj, lidhen me dëshmitarët. "Ata të cilët protestonin në Kosovë në vitin '99 kur NATO bombardonte caqet serbe për t'i shpëtuar shqiptarët, ata janë armiq të vendit tim dhe kombit tim", ka

thënë ai.

Ndërsa prokurorja e ka pyetur nëse deklaratimet e tij të mëparshme nënkuptojnë që të gjithë dëshmitarët kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së janë bashkëpunëtorë të serbëve. Gucati ka mohuar të ketë thënë diçka të tillë. "Po thoni që të gjithë dëshmitarët që kanë dëshmuar kundër anëtarëve të UÇK-së janë bashkëpunëtorë të serbëve", ka thënë prokurorja Bolici.

Kur prokurorja e ka pyetur nëse ka dëshmitarë të vrarë pasi kanë dëshmuar kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së, Gucati ka kërkuar që fjalët e tij mos të nxirren nga konteksti, por shkrimet e mëhershme të lexohen të plota. "Ku kam përmendur që të gjithë shqiptarët janë kundër? Ma gjeni një fakt apo një argument që unë paskam thënë të gjithë, ku dy

milionë shqiptarë jetojmë në Kosovë apo serb, rom, turq, e të gjithë. Nuk është e vërtetë, nuk është në jetën time kjo... Mos nxirrni fjalë nga konteksti, çfarë juve ju duhen. Lexoni komplet. Ju kisha lutur gjyqtarë të nderuar, të lexohet teksti deri në fund. Nuk është e vërtetë që kam thënë unë që dëshmitarët që kanë qenë kundër UÇK-së janë vrarë. Unë i bëj thirrje personit në fjalë, nëse di një rast, të jetë burrë e mos të ketë frikë të dëshmojë", ka thënë Gucati.

Ai ka theksuar se çdo vrasje që ka ndodhur duhet të zbulohet por, sipas tij, diçka e tillë nuk duhet të bëhet me padrejtësi dhe shantazhe.

Gjykimi ndaj Gucatit dhe Haradinajt ka filluar në muajin tetor të këtij viti, ndërsa Zyra e Prokurorit të Specializuar e ka mbyllur çështjen e saj në nëntor. Hysni Gucati së bashku me

Nasim Haradinajn po akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. "Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si dhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale", thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

ZKA-ja: Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje më të madhe menaxhimit të projekteve

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale SDC/DEMOS për vitin fiskal 2020".

Granti është bashkëfinancuar nga Fondacioni Zviceran në Kosovë/Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave.

Qëllimi i këtij auditimi ka qenë që të vlerësojë nëse shpenzimet dhe menaxhimi i projekteve kapitale të grantit të performancës komunale janë në harmoni me kërkesat e donatorëve dhe nëse kanë arritur rezultatet e synuara. Subjekt i auditimit kanë qenë komunat Pejë, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut dhe Kllokot.

Auditimi ka konkluduar se komunat në përgjithësi kanë aplikuar rregullat në fuqi ndërsa granti i performancës komunale i ka ndihmuar komunat për arritjen e objektivave strategjike. Ai ishte në funksion të qëllimit

për të ofruar shërbime më të mira të infrastrukturës komunale për qytetarët. Megjithatë, menaxhimi i projekteve dhe fondeve nga granti ka nevojë për vëmendje më të madhe duke filluar nga vendosja e prioritetëve, realizimi i projekteve dhe rezultatet e arritura.

Rezultatet e këtij auditimit tregojnë se procesi i prokurimit ende ka hapësirë për përmirësim në disa aspekte siç janë: përfshirja e projektit në planin e prokurimit publik,

përlogaritja e përafërt e vlerës së parashikuar të kontratës, evidentimi i pozicioneve të ndryshuara dhe trajtimi i drejtë i operatorëve ekonomikë në proceset tenderuese. Po ashtu, gjysma e projekteve të audituara nuk ishin realizuar me kohë dhe nuk janë në shfrytëzim të plotë nga qytetarët.

Arsyet për vonesa për realizimin e projekteve ndërlidhen me mosshpronësimet me kohë të pronave private dhe pengesat për shkak të zhvillimit të dy projekteve në kohë dhe zonë të

njëjtë.

Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, lidhur me këtë auditim ka vlerësuar se granti i performancës komunale në përgjithësi i ka ndihmuar komunat për arritjen e objektivave strategjike duke u ofruar qytetarëve projekte në lokacione të favorshme dhe qasje të lehtë në shfrytëzimin e tyre. Megjithatë, mungesa e efikasitetit për realizimin e kontratave dhe mangësitë e tjera të identifikuar zbehin rëndësinë e projekteve dhe

pengojnë maksimizimin e përfitimit nga granti i përcaktuar.

Zyra Kombëtare e Auditimit i ka rekomanduar komunat e audituara që ta forcojnë procesin e menaxhimit të projekteve nga granti i performancës komunale, duke filluar me planifikimin e duhur dhe me kohë të prokurimit deri te forcimi i kontrolleve për menaxhimin e kontratave duke siguruar realizimin e tyre sipas kushteve dhe specifikave të kontraktuara.



Të hënën seanca e radhës, do të diskutohet për Ligjin e Pagave



PRISHTINË, 8 DHJETOR (ER) - Seanca e radhës e Kuvendit të Kosovës do të mbahet të hënën në orën 11:00. Ndër pikat e tjera të rendit të ditës do të jetë edhe diskutimi për Ligjin e Pagave. Kështu u mor vendim gjatë mbledhjes së kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se seanca e ardhshme e Kuvendit të Kosovës do të mbahet më 13 dhjetor. "Seanca e radhës do të mbahet të hënën me fillim nga ora 11:00", ka thënë Tahiri para medieve.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, u shpreh i kënaqur se

gjatë kësaj seance do të diskutohet për Ligjin e Pagave në sektorin privat. "Në këtë seancë do të diskutohet një çështje shumë e rëndësishme, atë të Pagave në sektorin publik. Mendoj se ky debat po vjen në kohë të duhur, para miratimit të buxhetit që do të ndodhë më 22 dhjetor dhe shpresojmë që ky debat përmes një rezolute që ne do ta ngrehim përmes amendamentit që ne kemi bërë për pagat në sektorin publik, të realizohet dhe më 22 të buxhetohet Ligji i Pagave, në mënyrë që më së largu deri më 1 mars të hyjë në funksion ligji që rregullon pagat në sektorin publik", ka thënë Tahiri.

Kërkohet nga Ministria e Mjedisit të merret më seriozisht me çështjen e mbeturinave

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Të mërkurën anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike kanë mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën është shqyrtuar raportit i auditimit të performancës "Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale". Në mungesë të ministrit të Mjedisit, Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, raporti u paraqit nga Linda Çavdarbasha, zëvendësministre. Sipas Çavdarbashës, planifikohet të bëhet menaxhimi i mbeturinave dhe për këtë arsye ministria ka formuar një grup punues me qëllim që të bëhet shkurtrimi i numrit të qeseve të plastikës deri në vitin 2022. Megjithatë, sipas

anëtarëve të komisionit deri më tani nuk është marrë seriozisht sa duhet çështja e mbeturinave, ndonëse është jashtëzakonisht e rëndësishme për shëndetin e qytetarëve. U kërkua nga ministria përkatëse që të punohet sa ma shumë për përmirësimin e gjendjes sepse, siç u tha, deri më tani ka pasur plane, mirëpo asgjë konkrete.



Pse disa njerëz arrijnë të jetojnë mbi 100 vjeç dhe të tjerët jo?



Nga Richard Faragher & Nir BARZILAI

Një burrë 35-vjeçar ka vetëm 1.5 për qind shanse që të vdesë brenda 10 viteve të ardhshme. Por i njëjti burrë në moshën 75-vjeçare, ka 45 për qind shanse që të vdesë para se të mbushë 85 vjeç. Është e qartë se plakja është një gjë e keqe për shëndetin tonë.

Aspekti pozitiv është se dekadat e fundit kemi shënuar një përparim të paparë sa i përket kuptimit të mekanizmave themelorë që kontrollojnë plakjen dhe sëmundjet e moshës së thyer. Disa procese biologjike të lidhura ngushtë me të, të quajtura ndonjëherë “shenjat dalluese të plakjes”, përfshirë furnizimin tonë me qeliza staminale dhe komunikimin midis qelizave, veprojnë për të na mbajtur të shëndetshëm në fillim të jetës sonë.

Problemet nisin të lindin pasi këto qeliza fillojnë që të dështojnë në funksionin e tyre. Aktualisht po zhvillohen teste për të parë nëse synimi i disa prej këtyre shenjave dalluese, mund të përmirësojë

sëmundjen e veshkave, aspektet e funksionit imunitar dhe alveolat e mushkërive të lidhura me moshën.

Por fatkeqësisht, pyetje të tjera të mëdha mbi biologjinë e plakjes, vazhdojnë të mbeten pa përgjigje. Për të vlerësuar se cilat janë këto dhe si t'u japim përgjigje, Federata Amerikane për Kërkimet mbi Plakjen, një organizatë bamirëse, organizoi kohët e fundit një seri takimesh me shkencëtarët më të njohur të fushës.

Ekspertët ranë dakord se të kuptuarit e asaj që është e veçantë tek biologjia e njerëzve që jetojnë më shumë se një shekull, mbetet ende një sfidë kryesore. Këta 100 vjeçarë përbëjnë më pak se 0.02 për qind të popullsisë së Mbretërisë së Bashkuar, por e kanë tejkaluar me gati 50 vjet jetëgjatësinë e bashkëmohatarëve të tyre (të lindurit në vitet 1920, zakonisht kishin një jetëgjatësi më të vogël se 55 vjeç).

Po si ia dalin të jetojnë aq gjatë? Ne e dimë në përgjithësi se 100 vjeçarët jetojnë kaq gjatë sepse janë shumë të shëndetshëm. Ata qëndrojnë në shëndet të mirë për rreth 30

vjet e më shumë se sa shumica e njerëzve normalë, dhe kur sëmurën para se të vdesin, kjo ndodh për një kohë shumë të shkurtër.

Ky “kompresim i sëmundshmërisë”, është padyshim i mirë për ta, por i sjell dobi edhe shoqërisë në tërësi. Në SHBA, kostot e kujdesit mjekësor për 1 njeri mbi 100 vjeç në dy vitet e fundit të jetës së tij, janë 1/3 e atyre që vdesin në të 70-at (shumica e 100 vjeçarëve nuk kanë nevojë as të shkojnë tek mjeku).

Po ashtu fëmijët e atyre që jetojnë mbi 100-vjeç janë shumë më të shëndetshëm se mesatarja, gjë që tregon se ata po trashëgojnë diçka të dobishme nga prindërit e tyre. Por a është përcaktuese gjenetika apo mjedisi në jetëgjatësinë e tyre të pazakontë?

Por a janë vërtet këta njerëz model se si është një mënyrë jetese e shëndetshme? Për popullatën e përgjithshme, pasja nën kontroll e peshës, mos-pirja e duhanit, pirja e moderuar e alkoolit dhe ngrënia e të paktën 5 racioneve me fruta dhe perime në ditë mund të rrisë deri në 14 vjet

jetëgjatësinë, krahasuar me dikë që nuk bën asnjë nga këto gjëra.

Por çuditërisht, ky nuk duket se është rasti për njerëzit që jetojnë gjatë. Një studim zbuloi se deri në 60 për qind e 100 vjeçarëve hebrenj Ashkenazi, kanë pirë shumë duhan shumicën e jetës së tyre, gjysma kanë qenë obezë gjatë të njëjtës periudhë kohore, më pak se gjysma bëjnë ushtrime fizike të moderuara dhe më pak se 3 për qind janë vegjetarianë. E megjithatë krahasuar me bashkëmohatarët me të njëjtin konsum ushqimi, pasuri dhe peshë trupore, ata janë 50 për qind më pak të prekur nga sëmundjet kardiovaskulare.


Ndaj duket sikur ka diçka të jashtëzakonshme tek këta njerëz. A mund të jetë kjo për shkak të gjenetikës së rrallë? Nëse po, atëherë kjo mund të funksionojë në 2 mënyra. Këta njerëz mund të kenë variante gjenetike të pazakonta që ia zgjasin jetën, ose mund t'u mungojnë variantet e zakonshme që shkaktojnë sëmundje dhe dëmtime të vonshme.

Disa studime, duke përfshirë

studimin tonë, kanë treguar se 100 vjeçarët kanë po aq variante gjenetike të këqija sa edhe popullata në përgjithësi. Madje disa prej tyre bartin 2 kopje të gjenit më të madh, që njihet për rrezikun e shkaktimi të sëmundjes së Alzheimerit (APOE4), e megjithatë nuk preken nga kjo sëmundje.

Kësisoj, një hipotezë e besueshme është se 100 vjeçarët mbartin variacione të rralla gjenetike të dobishme, dhe jo mungesë të atyre të pafavorshme. Mbi 60 për qind e tyre kanë ndryshime gjenetike që i ndryshojnë ato. Por këta njerëz janë të ndryshëm nga ne të tjerët edhe në mënyra të tjera.

Për shembull, ata priren që të kenë nivele të mira të kolesterolit, duke lënë të kuptohet se mund të ketë disa arsye për jetëgjatësinë e tyre. Tek e fundit, 100 vjeçarët janë në vetvete “eksperimente natyrore”, që na tregojnë se është e mundur të jetojë gjatë dhe me një shëndet shumë të mirë, nëse kemi disa veçanti që nuk i kanë të tjerët, shumica e të cilave mbeten ende të pa kuptuara nga ekspertët. / “The Conversation” – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-DONAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Rrahmani: Ndeshja ndaj Leicesterit është jetike, luajmë për fitore



NAPOLI, 8 DHJETOR - Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, ka folur në konferencë për shtyp një ditë para ndeshjes që skuadra e tij, Napoli, e zhvillon ndaj Leicester Cityt në Ligën e Evropës. Mbrojtësi nga Drenica e ka vlerësuar si ndeshje të rëndësishme takimin me "Dhelprat", ndërsa ka thënë se do ta japin maksimumin për fitore për faktin se fati i skuadrës vendoset në këtë ndeshje. "Është ndeshje e rëndësishme për ne dhe ata. Në këto ndeshje delikate mund t'i

shohësh lojtarët e vërtetë. Ne japim gjithçka në fushë, hyjmë me koncentrimin dhe synimin që të japim më të mirën. Kjo ndeshje është e veçantë sepse 90 minutat do të vendosin për fatin e dy skuadrave. Duhet të jemi gati dhe të japim gjithçka nga vetja", ka thënë Rrahmani, i cili me ardhjen e trajnerit Luciano Spalletti ka më shumë minuta në fushë. "Me Spallettin ka ndryshuar tani sepse luaj më shumë. Në një skuadër të fortë si Napoli duhet të jenë gjithmonë dy lojtarë për çdo

pozitë dhe katër për qendër. Trajneri gjithmonë ka shumë kërkesa që ndryshojnë dhe ne duhet të jemi gati. Si lojtar është normale për të gjithë që të kenë ëndrra në këto ndeshje. Ti duhet të përmirësohesh edhe kur luan në një skuadër ku është më i miri në botë. Ka çaste që vijnë e duhet të presësh, por ka gjithmonë vende për këto çaste", deklaroi ai. Ndeshja ndërmjet Napolit dhe Leicester Cityt luhet të enjten me fillim nga ora 18:45 në stadiumin "Diego Armando Maradona" në Napoli.

SHKURT

U19-shat mësojnë rivalët në kualifikimet për Kampionatin Evropian

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll në grupmoshën U19 ka mësuar të mërkurën kundërshtarët e grupit në eliminatorët për Kampionatin Evropian 2022. Kosova është në Grupin 3. Ajo të garojë me Suedinë, Ukrainën dhe Qipron. Edhe pse ky cilësohet si një grup shumë i vështirë, dardanët e rinj pritët të kenë një performancë të mirë dhe të arrijnë rezultate sa më pozitive. Shqipërisë i ka rënë shortoi në Grupin 7 me Spanjën, Belgjikën dhe Rusinë. Në bazë të rregullores dy skuadrat e renditura në vendin e parë të çdo grupi do të avancojnë në "Elite Round" së bashku me skuadrën e tretë më të mirë të eliminatorëve.

U17-shat i mësojnë rivalët për Kampionatin Evropian

Të mërkurën është tërhequr shorti për Kampionatin Evropian U17 për vitin 2022/23. Përfaqësuesja e Kosovës U17 për herë të dytë në histori do të jetë pjesëmarrëse në këtë grup, por nuk është që ka pasur shumë fat në short. "Dardanët" e rinj janë në grupin e tetë me Italinë, Greqinë dhe Finlandën. Kujtojmë se shkak i rregullave të UEFA-s Kosova e kishte të ndaluar të takohej me Serbinë, Bosnjë dhe Hercegovinën dhe Rusinë. Ndryshe, Kombëtarja e Shqipërisë ndodhet në grupin e shtatë me Suedinë, Kroacinë dhe Uellsin.

Vdes ish-portieri shqiptar pas infektimit me Covid-19

Ditë zie për futbollin shqiptar dhe skuadrën e Apolonisë së Fierit. Ka ndërruar jetë në moshën 50-vjeçare ish-portieri Arben Sinani. Ky lajm është bërë me dije nga miqtë dhe të afërmit e tij, raportojnë mediet shqiptare. Sinani është ndarë nga jeta si pasojë e COVID-19 duke mos e fituar dot betejën me virusin. Një lajm i hidhur ky për futbollin shqiptar, klubin e Apolonisë, familjarët dhe miqtë e tij pas ndarjes nga jeta të ish-portierit Arben Sinani.

Granit Rugova, u. d. i drejtorit ekzekutiv i Ligës Unike

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Bordi i Ligës Unike ka vendosur që Granit Rugova të jetë ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv të Ligës Unike. Ky vendim vjen pas dorëheqjes nga Dren Zatriqi. Rugova është drejtor i përfaqësuesëve të Kosovës dhe ka përfunduar Programin Time Out 2.0 nga FIBA. Përvoja që ka Rugova

do ta ndihmojë që Liga Unike të vazhdojë së funksionuari sipas marrëveshjes së themelimit. Rugova nuk do të ketë një punë të lehtë, megjithatë është i motivuar që ta kryejë me sukses. Liga Unike bashkon klubet e Kosovës dhe ato të Shqipërisë, kurse në këtë edicion ka filluar edhe në konkurrencën e femrave.

Është hera e parë që një ligë bashkon klubet më të mira nga të dyja shtetet dhe një ëndërr që po realizohet dhe ishte menduar se nuk do të funksiononte asnjëherë. Ish-basketbollisti i cili ka fituar shumë trofe në karrierën e tij do ta fillojë punën menjëherë me klubet dhe partnerët në mënyrë që gjithçka të shkojë sipas planit.



Brooklyni forcon pozitën në krye të renditjes në Lindje, lakersat fitojnë ndaj LeBronit

LOS ANXHELOS, 8 DHJETOR - Tri ndeshje të luajtura në NBA. Skuadra e Brooklyn Netsit ruan kreun e renditjes në Lindje pas fitores 102-99 ndaj Dallasit. Fitore e vështirë e ekipit mik, sukses që erdhi nga duart e

Durantit, 24 pikët e Hardenit, 23 pikët e 12 asistime. Fiton edhe skuadra e lakersave, që e mundi me rezultat 117-102 Bostonin, ndeshje e dominuar nga kalifornianët. Tatum realizoi 34 pikë për miqtë, por që

s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Për lakersat u dalluan James me 30 pikë dhe Westbrook me 24 pikë e 11 asistime. Zhgënjën sërish ekipi i San Antonios, që në fushën e tij u mund 121-109 nga New Yorku. Barrett me

32 pikë ishte lider në fushë për miqtë, ndërkohë që 47 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Rezultatet: Dallas-Brooklyn (99-102), San Antonio-New York (109-121), Lakers-Boston (117-102).



Simitçiu: Do të bëjmë çmos për ta kaluar grupin



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futsall ka mësuar kundërshtarët me të cilët do të përballet në paraeliminoret e Kupës së Botës 2024. "Dardanët" e futsalit, të drejtuar nga Arben Simitçiu, kanë tërhequr shortin në Grupin C dhe do të kenë punë

me Armeninë, Bullgarinë dhe Skocinë. Ndeshjet e këtij rrethi do të zhvillohen në muajin prill në Bullgari. Sipas rregullores, më tutje kalojnë dy skuadrat e para të çdo grupi. Lidhur me shortin, përzgjedhësi Simitçiu përfaqëson zyrtarë të FFK-së ka thënë se shorti nuk ka qenë i lehtë, por se do të bëhet çmos

për ta kaluar këtë fazë të garave. "Grupi është i vështirë por, realisht, çdo grup është i fortë, sepse sot futsalli në të gjitha shtetet e Evropës është ngritur në kualitet dhe ekipet janë shumë të mira. Për mendimin tim Armenia është ekipi më i fortë në grup, pasi ka 3-4 brazilianë të natyralizuar në ekip. Edhe Bullgaria është ekip i mirë që do të pretendojë ta kalojë grupin, duke e shfrytëzuar edhe faktorin e terrenit vendës, teksa duhet vlerësuar edhe kualiteti i Skocisë. Sidoqoftë, plani ynë është i qartë, bashkë me 'Dardanët' e Kombëtares do të bëjmë çmos për ta kaluar grupin dhe të kualifikohemi në 'Main Round', ka thënë Simitçiu.

Broja: Premierë Liga, ëndërr e realizuar

SOUTHAMPTON, 8 DHJETOR - Konsiderohet me të drejtë e ardhmja e sulmit të kombëtares shqiptare. Jo më kot nënshkroi kontratë pesëvjeçare me Chelsea, sepse vlerat i ka të mëdha, edhe pse ende vetëm 20 vjeç. Pas golave në Hollandë, i huazuar te Vitesse Holandionin e kaluar, Armando Broja po e bën këtë edhe aktualisht në Premierë Ligë. Për momentin pesë janë golat e tij në këtë sezon si pjesë e "Shenjtorëve", të cilët i japin statusin e golashënuesit më të mirë në ekipin ku është huazuar për një vit. "Po e shijoj vërtet. Është pa dyshim sezoni im i parë në Premierë Ligë. Unë jam një lojtar i ri dhe është e mahnitshme që kam mundësi për të qenë në Premierë Ligë dhe për të fituar përvojë. Këtu do të bëhem një lojtar më i mirë. Është një ëndërr e realizuar. Unë, thjesht, po përpiqem të përmirësohem

çdo ditë dhe të mësoj. Sigurisht që ka gjithmonë konkurrencë. Është Premierë Ligë. Është liga më e vështirë. Gjithmonë do të ketë konkurrencë në ekip. Unë, thjesht, do të mbaj kokën ulur dhe do të përpiqem ta ndihmoj ekipin sa më shumë që të jetë e mundur. U lumturova që shënova të shtunën, por gjëja kryesore është skuadra. Ishte e turpshme pse nuk arritëm t'i merrnim tri pikët", ka thënë Broja. Duke reflektuar mbi barazimin ndaj Brightonit, Broja, i cili tashmë ishte zëvendësuar nga Armstrong, kur Maupay gjeti golin e ekuilibrit, ka deklaruar: "Sigurisht që është zhgënjyese. Është një goditje e madhe të pësosh një gol të tillë. Pa dyshim që nuk është gjëja më e mirë për ne, por mendoj se performanca e përgjithshme ishte vërtet e mirë. Mendoj se e kontrolloam lojën, e dominuam ndeshjen,



është për të ardhur keq të pësosh gol në fund. Nuk është ajo që dëshironi. Ne vetëm duhet të vazhdojmë të ecim përpara, të përmirësohemi dhe të punojmë shumë. Është Premierë Ligë, gjithçka mund të ndodhë. Është liga më e mirë në botë. Një shans pati kundërshtarit dhe shënoi një gol. Nuk ishte rezultati ideal për ne. Sidoqoftë, thjesht do të vazhdojmë të ecim përpara. Do ta sfidojmë Arsenalin në ndeshjen e ardhshme".

SHKURT

Hysaj: Strakosha dhe Reina janë dy portierë të fortë

Mbrojtësi shqiptar i Lazios, Elseid Hysaj, ka thënë se 'nuk ka dallim' mes lojës me Thomas Strakoshën apo Pepe Reina pasi, sipas tij, të dy janë portierë cilësorë. "Biancocelestët" përgatiten të enjten për ndeshjen e tyre në "Olimpico" ndaj gjigantit turk Galatasaray në kuadër të Ligës së Evropës. Lazio është tashmë në fazën tjetër me tetë pikë nga pesë ndeshje, pasi ka një diferencë prej katër pikësh me Marseillen në vendin e tretë. Hysaj beson se Aquile është duke treguar shenja përmirësimi në javët e fundit, por theksoi se duhet kohë për t'u përshtatur me trajnerin e ri. "Jemi përmirësuar shumë. Ne shënojmë gola. Duhet të mësojmë të mos pësojmë. Duhet kohë për të përthithur të gjitha kërkuesat nga trajneri. Nëse doni të luani me një linjë të lartë në mesfushë, nuk mund të humbni asgjë. Ka ndeshje në të cilat jemi të sigurt, të tjera në të cilat pranojmë katër gola. Nuk është mirë. Duhet të jemi më të ngushtë dhe të komunikojmë më shumë", ka thënë Hysaj. Mbrojtësi shqiptar u pyet nëse ndryshon diçka kur në portë luan Strakosha apo Pepe Reina, por ish-lojtari i Napolit theksoi se të dy janë portierë cilësorë. "Nuk ka dallim, ata janë dy portierë të fortë. Njëri ka më shumë përvojë, tjetri ende duhet të rritet", ka shtuar Hysaj.

Mbappe: Lehtë të luash me Messin, është më i miri në botë

Kylian Mbappe e ka lavdëruar Lionel Messin. Të dy sulmuesit kanë shkëlqyer duke shënuar nga dy gola në ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Brugge. "Është shumë e lehtë të luash me Leo Messin. Ai është më i miri në botë. Ai e fitoi 'Topin e Artë' vetëm pak ditë më parë. Shënoi dy gola tani dhe është i lumtur. Shpresoj të na ndihmojë në të ardhmen", ka thënë Mbappe.

Marcelo në verë largohet nga Reali, shkon te Fluminense

Pas 16 vjetësh fitoresh dhe triumfesh, Marcelo do të largohet nga Real Madridi verën e ardhshme. Gazeta argjentinase "Ole" raporton se Marcelo, pavarësisht prej disa ofertave nga Evropa, do të kthehet në Brazil, për ta mbyllur karrierën te Fluminense. 33-vjeçari nga viti 2007 është pjesë e Realit, ku ka regjistruar 377 paraqitje dhe ka shënuar 26 gola.

Kloppi krenohet me fitoren ndaj Milanit, lavdëron Ibrën

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, përgëzon lojtarët e tij për karakterin e treguar në "San Siro", duke shënuar fitore me rezultat 1-2 ndaj Milanit. "Dëshironim ta luanim dhe ta fitonim këtë ndeshje. Jam shumë i lumtur për paraqitjen e djemve. Jam krenar për këtë ekip dhe për zemrën që vendosën në fushë. Ibra? Kam shumë respekt për të. Të duhet shumë punë të luash në këto nivele në moshën 40-vjeçare, por jo nëse quhesh Ibrahimoviç. Karriera e tij e shkëlqyer tregon qartë kush është Ibra", ka thënë Klopp.

Pioli: Na vjen keq që largohemi nga Evropa

Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, ka thënë se i vjen keq që skuadra kuqezi është eliminuar nga Evropa. Ai ka bërë me dije se tash forcat

Milani do t'i përqendrojë në kampionat dhe Kupë. "Na vjen keq që largohemi nga Evropa, por e dinim që do të ishte e vështirë. Na duhej më

shumë ritëm dhe kualitet por, për fat të keq, nuk i kishim. E lëvizëm topin lehtë dhe ishim pak preciz. I dhuruam dy gola dhe në

këto nivele, nëse nuk shprehesh në maksimum, nuk ia del. Tani vëmendja në Serinë A? Ne dëshironim të shkonim më tej në Evropë.

Ky ishte objektivi ynë. Tani duhet të jemi të zotë t'i përqendrojmë forcat në kampionat dhe Kupë", ka thënë Pioli.

Në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087 nenet 17 dhe 21 si dhe Ligjit Nr. 04/L-111 për plotësim ndryshim e Ligjit për ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087, Nenet 9 dhe 13 me të cilat nene, plotësohen dhe riformulohen Nenet 17 dhe 21 të Ligjit bazik, Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 06/L-021., Për Kontrollin e brendshëm të financave publike Nr.06/L-021 nenit 22 si dhe vendimit të Komisionit për Auditim të TK Sh.A., nr. 6 me nr. Protokolli 01-3712/21 të datës 01.11.2021, Komisioni për Auditim i TK Sh.A., shpall këtë:

KONKURS PËR VEND TË PUNËS

Titulli i punës: **Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm**
 Raportoni: Komisionit për Auditim të TK sh.a.
 Grada: G-17
 Mandati: 3 (tre) vite
 Vendi: Prishtinë
 Ndërmarrja: Telekom i Kosovës Sh. A

Nr. i Referencës: 01-3712/21

Afati i fundit për aplikim : 10.01.2022

PËRSHKRIMI I NDËRMARRJES

Telekomi i Kosovës Sh. A (TK) është ndërmarrje publike e licencuar për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të telekomunikacionit në një treg të hapur duke sjellë inovacione dhe risi në tregun e telekomunikacionit. TK është në kërkim të: **Zyrtar për Auditim të Brendshëm** me kualifikim, integritet të njohur dhe përvojë të nevojshme profesionale që do të udhëheqë Departamentin e Auditimit të Brendshëm në përputhje me parimet e njohura për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike.

Titulli i punës: **Zyrtar për Auditim të Brendshëm**

Duke i raportuar Komisionit të Auditimit të TK sh.a., Zyrtari për Auditim të Brendshëm është përgjegjës për vlerësimin e përshtatshmërisë ligjore dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme në përputhje me planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm në TK sh.a..

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat kryesore për Zyrtarin e auditimit të brendshëm janë:

- Të rrisë dhe mbroj vlerën e organizatës duke ofruar siguridhënie përmes auditimit dhe këshillëdhënies të bazuar në rrezik dhe objektivë.
- Të menaxhoj dhe organizoj funksionin e Auditimit të Brendshëm të NP Telekom i Kosovës sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (IIA).
- Të hartojë Politikën e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Misionin e Auditimit të Brendshëm dhe elementët e detyrueshëm të Kuadrit të Praktikave Profesionale Ndërkombëtare (Parimet Thelbësore të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës, Standardeve dhe Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm). Auditori i Brendshëm duhet të rishikojë periodikisht statutin e auditimit të brendshëm dhe ta paraqesë atë për miratim të Komisioni I Auditimit.
- Të hartoj dhe propozoj planin strategjik dhe vjetor të Auditimit të Brendshëm të TK-së për shqyrtim dhe miratim nga Komisioni i Auditimit .
- Të raportojë Komisionit të Auditimit të TK-së për procesin e auditimit sipas Planit të Auditimit.
- Planifikon proceset e auditimit përmes së cilave vlerësohen kontrollet e brendshme dhe performaca, në pajtueshmëri me standardet profesionale;
- Përgatit dhe ekzekuton programe auditimi për të kryer auditime sipas planit vjetor duke përcaktuar objektivat e auditimit, kriteret e auditimit dhe duke identifikuar rreziqet dhe kontrollet;
- Dizajnon procedura testimi me qëllim të vlerësimit të adekuatshmërisë së kontrolleve të brendshme për përmbushje të objektivave të auditimit;
- Siguron, analizon dhe vlerëson të dhënat mbështetëse (evidencat) përmes veglave të ndryshme ndihmëse;
- Përgatit raportet e auditimit që pasqyrojnë qartë objektivat e auditimit, fushëveprimin, gjetjet, rekomandimet, konkluzione;
- Kryen përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të mëhershme ;
- Kryen Ad Hock auditime dhe detyra tjera me kërkesën e Komisionit të Auditimit TK-së;
- Siguron dokumentimin e letrave të punës sipas metodologjisë së aprovuar;
- Të ndihmoj në ruajtjen e kontrolleve efektive përmes: (i) Vlerësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të kontrolleve.(ii) Nxitjes së përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit të kontrollit dhe (iii) Identifikimit të mundësive për përmirësimin e aktivitetit të kontrollit.
- Ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e qeverisjes përmes: (i) Nxitjes së etikës dhe vlerave të përshtatshme. (ii) Ofrit të siguridhënies të menaxhimit efikas të performancës dhe llogaridhënies. (iii) Komunikimit efektiv të informacionit të rrezikut dhe kontrollit. (iv) Koordinimit efektiv i aktiviteteve të siguridhënies.
- Të demonstroj integritet, kompetencë dhe kujdesin e duhur profesional. Të jetë objektiv dhe i pavarur, të përshtatet me strategjinë, objektivat dhe rreziqet e TK-së. Të jetë proaktiv dhe i fokusuar në të ardhmen që të rekomandoj dhe këshillojë përmirësim e kontrollet të brendshëm të TK-së.

- Të promovojë kulturë etike në ushtrimin e profesionit të auditimit të brendshëm duke respektuar parimet fundamentale dhe rregullat e sjelljes të përcaktuara me Kodin e Etikës së Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (Parimet Fundamentale sipas Kodit të Etikës: Integriteti, Objektiviteti, Konfidencialiteti, Kompetenca).

Kushtet dhe kriteret që zyrtari i auditimit të brendshëm duhet t'i plotësoj:

- Të ketë diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet(diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHTI-t);
- Të ketë certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave (dëshmi);
- Të është anëtar aktiv në listën e njërës nga organizatat e akredituara në Kosovë (dëshmi);
- Të ketë vijuar Edukim të Vazhdueshëm Profesional, duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) viteve të njëpasnjëshme (2019/2020), në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021 (dëshmi);
- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 9 dhe 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Kandidati duhet të ketë përvojë në menaxhim financiar/auditim. Preferohen individët me përvojë pune në ndërmarrjet korporata tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë;
- Kandidati duhet të posedojë aftësi për kryerjen e një game të gjerë të aktiviteteve, përfshirë këtu vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm, analizën e informacioneve financiare dhe jo financiare, kontrollimin e aktiviteteve operacionale, zbulimin e gabimeve të mundshme brenda entitetit dhe gjithashtu ofrimin e sugjerimeve të nevojshme për përmirësim;
- Aftësi të forta bindëse/ndër personale;
- Zotësi për t'u përshtatur në situata të pa-planifikuara, apo të ndryshuar, fleksibilitet të planeve dhe masat për t'u përballur me rrethanat e tilla;
- Zotësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
- Pavarësia dhe niveli i lartë i integritetit përgjatë aktiviteteve në korporatë;
- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme të TK Sh. A, si dhe aftësia për të marrë vendime të rëndësishme në situatat e vështira;
- Preferohet njohuri e mirë e gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur.

Aplikacionet duhet të dërgohen të shkruara në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës dhe mund të merren online në www.kosovotelecom.com.

Kërkesa/aplikacioni për punësim se bashku me CV të detajuar, letër motivuese, dëshminë e kualifikimit, përvojës, certifikata nga gjykata kompetente për mosqenie nën hetime jo me e vjetër se 6 muaj dhe Deklaratën nën Betim të nënshkruar (të cilën mund ta merrni online në www.kosovotelecom.com), duhet të dorëzohen personalisht në zarf të mbyllur në zyrën e arkives qendrore kati VI, zyra nr.603. Ndërtesa Kryesore e TK Dardania pa nr. 10000 Prishtine, Republika e Kosovës.

Letër-Referencat nuk kërkohet të dorëzohen në këtë fazë.

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
 Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 08.12.2021 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Shpallje Publike : T-21-009

- Loti 1. Me kontratë shpërblehet "ARS shped" dhe Nani Shped" me ofertë 147.13 € me TVSH.
- Loti 2. Me kontratë shpërblehet N.P.T "Servis Shped" me ofertë 150.23 € me TVSH.
- Loti 3. Me kontratë shpërblehet Mondit Shped me ofertë 144.03 € me TVSH.
- Loti 4. Me kontratë shpërblehet NTSH "Auto Shped" me ofertë 116.36 € me TVSH.
- Loti 5. Me kontratë shpërblehet NSH "Rahova Shped" me ofertë 116.36 € me TVSH.
- Loti 6. Me kontratë shpërblehet Agjencion Doganor "Enishped" dhe Fitimi Shped me ofertë 116.36 € me TVSH.
- Loti 7. Me kontratë shpërblehet Ideal Shped me ofertë 128.24 € me TVSH.
- Loti 8. Me kontratë shpërblehet NTSH Duo Shped me ofertë 128.24 € me TVSH.
- Loti 9. Me kontratë shpërblehet Germova 2 sh.p.k me ofertë 283.53 € me TVSH.
- Loti 10. Me kontratë shpërblehet NTP Gima me ofertë 100.67 € me TVSH.
- Loti 11. Me kontratë shpërblehet BKS me ofertë 68.87 € me TVSH.
- Loti 12. Me kontratë shpërblehet Zyra e shërbimeve afariste"Proka" me ofertë 111.62 € me TVSH.
- Loti 13. Me kontratë shpërblehet Shpedicion "Extra Shped" me ofertë 108.83 € me TVSH.
- Loti 14. Me kontratë shpërblehet A shped dhe Floj me ofertë 171.40 € me TVSH.
- Loti 15. Me kontratë shpërblehet Agjencion Doganor "Real Shped" me ofertë 183.79 € me TVSH.
- Loti 16. Me kontratë shpërblehet Agjencion Doganor "Alpha Shped-i" me ofertë 109.24 € me TVSH.
- Loti 17. Me kontratë shpërblehet N.P.N "Asllan & Sons" me ofertë 109.24 € me TVSH.
- Loti 18. Me kontratë shpërblehet Bobi sh.p.k me ofertë 96.54 € me TVSH.
- Loti 19. Nuk ka ofertë
- Loti 20. Nuk ka ofertë.

Kontratat janë paraparë të nënshkruhen me datë 19.12.2021 ora 10:00 (Matja hapësirave do behet 13.12.2021)

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Na osnovu Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, članovi 17. i 21. kao i Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, članovi 9 i 13, kojima se dopunjuju i reformulišu članovi 17 i 21 osnovnog zakona, Kodeksa etike i korporativnog upravljanja za javna preduzeća, Zakon br. 06/L-021 o internoj kontroli javnih finansijskih, član 22. kao i Odluke Komisije za reviziju, TK a.d. sa brojem protokola 01-3712/21 donetoj na sastanku Komisije za Reviziju br.6 dana 01.11.2021, Komisija za reviziju TK a.d. raspisuje:

KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: **Službenik/ca za unutrašnju reviziju**
Izveštava: Komisiji za reviziju TK a.d.
Stepen: G-17
Mandat: 3 (tri) godine
Radno mesto: Priština
Preduzeće: Telekom Kosova a.d.

Referentni Broj: 01-3712/21
Zadnji rok za prijavu: 10.01.2022

OPIS PREDUZEĆA

Telekom Kosova a.d. (TK) je javno preduzeće licencirano za pružanje telekomunikacionih usluga i proizvoda na otvorenom tržištu, donoseći inovacije i novine na tom tržištu. TK želi popuniti položaj **Službenika/ce za internu reviziju**, sa kvalifikacijom, poznatim integritetom i potrebnim stručnim iskustvom, kako bi rukovodio Departamentom za Unutrašnju reviziju u skladu sa poznatim načelima za korporativno upravljanje javnim preduzećima.

Naziv radnog mesta: Službenik/ca za Unutrašnju Reviziju

Uz podnošenje izveštaja Odboru direktora, službenik/ca za unutrašnju reviziju je odgovoran/a za procenu efikasnosti finansijskih dokumenata i njihovu usklađenost sa zakonima, u skladu sa Godišnjim planom revizije TK-a.

Glavni zadaci, odgovornosti i nadležnosti službenika/ce za unutrašnju reviziju su da:

- Poveća i zaštititi vrednost organizacije pružanjem sigurnosti putem revizije i saveta zasnovanim na riziku i cilju.
- Upravlja i organizuje funkciju interne revizije JP Telekom Kosova, prema Međunarodnim standardima interne revizije (IIA).
- Izrađuje politiku interne revizije, u skladu sa misijom Interne revizije i obavezanim elementima Međunarodnog okvira stručne prakse (Osnovni principi stručne prakse interne revizije, Kodeks etike, standardi i definicija interne revizije). Interni revizor treba da periodično pregleda statut interne revizije i da ga podnosi Komitetu za reviziju na odobrenje.
- Izrađuje i predlaže strateški i godišnji plan interne revizije TK-a za razmatranje i usvajanje od strane Komisije za reviziju.
- Izveštava Komisiju za reviziju TK-a o procesu revizije prema Planu revizije.
- Planira procese revizije kroz koje se procenjuju unutrašnje kontrole i radni učinak, u skladu sa profesionalnim standardima;
- Priprema i sprovodi programe revizije za primenu revizija u skladu sa godišnjim planom uz utvrđivanje ciljeva revizije, kriterijuma revizije i identifikovanje rizika i kontrola;
- Dizajnira postupak testiranja u cilju procene adekvatnosti unutrašnjih kontrola za ispunjavanje ciljeva revizije;
- Obezbeđuje, analizira i ocenjuje prateće podatke (dokaze) uz pomoć različitih sredstava;
- Priprema revizorske izveštaje koji jasno odražavaju ciljeve revizije, obim, nalaze, preporuke, zaključke;
- Prati sprovođenje prethodnih preporuka;
- Obavlja ad hok revizije i druge poslove na zahtev Komisije za reviziju TK-a;
- Obezbeđuje dokumentovanje radnih spisa po odobroj metodologiji;
- Pruža pomoć u održavanju efektivnih kontrola kroz: (i) procenu efektivnosti i efikasnosti kontrola (ii) promovisanje stalnog poboljšanja okruženja kontrole; i (iii) utvrđuje mogućnosti za poboljšanje aktivnosti kontrole.
- Pruža pomoć pri ocenivanju i poboljšanju upravljanja kroz: (i) Promovisanje odgovarajuće etike i vrednosti. (ii) Obezbeđuje efikasno upravljanje radnim učinkom i odgovornošću. (iii) Efikasno sapaštava informacije o riziku i kontroli. (iv) Efikasno koordinira aktivnosti bezbednosti.
- Treba da pokaže da poseduje integritet, sposobnost i odgovarajuću profesionalnu pažnju. Da bude objektivna i nezavisna, da se prilagodi strategiji, ciljevima i rizicima TK-a. Trba da bude proaktivna i usredsređena na budućnost, kako bi bio u stanju da preporuči i savetuje poboljšanje interne kontrole TK-a.
- Promoviše kulturu etike u vršenju profesije interne revizije uz poštovanje osnovnih principa i pravila ponašanja utvrđenih u Kodeksu etike, međunarodnim standardima interne revizije (Osnovni principi Kodeksa etike: Integritet, Objektivnost, Poverljivost, Sposobnost .

Uslovi i kriterijumi koje službenik za internu reviziju treba da ispuni

- Da ima univerzitetsku diplomu iz ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih oblasti studija koje su relevantne za sektor koji će biti predmet revizije (diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MPNTI-a);
- Da poseduje sertifikat internog revizora u javnom sektoru, izdatom od strane Ministarstva za finansije ili sertifikat za internog revizora u javnom sektoru izdatog od relevantne međunarodne ili domaće institucije u skladu sa kriterijumima koje izdaje ministar za finansije (dokaz);
- Da bude aktivan član u listi jedne od akreditovanih organizacija na Kosovu (dokaz);
- Da ima kontinuirano stručno obrazovanje, da je pohađao šezdeset (60) časova obuke u roku od dve (2) uzastopne godine (2019/2020), u skladu sa kriterijumima iz člana 25. Zakona o unutrašnjoj kontroli javnih finansija br. 06 / L-021 (dokaz);
- Da ispuni kriterijume za službenike kompanije, prema članovima 9 i 13, Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona o javnim preduzećima;
- Kandidat mora imati iskustva u finansijskom upravljanju ili reviziji. Poželjni su pojedinci sa radnim iskustvom u drugim velikim i složenim korporativnim preduzećima;
- Kandidat mora imati veštine za obavljanje širokog spektra aktivnosti, uključujući ocenjivanje sistema interne revizije, analizu finansijskih i nefinansijskih informacija, kontrolu poslovnih aktivnosti, otkrivanje mogućih grešaka unutar subjekta, kao i davanje predloga za poboljšanja.
- Jaku sposobnost ubeđivanja;
- Sposobnost prilagođavanja neplaniranim ili promenjenim situacijama i pružanje fleksibilnih planova i mera za suočavanje sa takvim okolnostima;
- Sposobnost delegiranja i praćenja ovlašćenja i odgovornosti saradnicima koji će obavljati delegirane funkcije;
- Nezavisnosti i integriteta pri obavljanju poslova u kompaniji.
- Sposobnost rukovođenja ka postizanju opštih ciljeva TK-a, kao i sposobnost donošenja važnih odluka u teškim situacijama;
- Preporučuje se dobro poznavanje engleskog jezika (pismeno i usmeno izražavanje).

Obrazac prijave na konkursu treba da se popuni na jednom od zvaničnih jezika koji se upotrebljavaju u Republici Kosova i mogu se preuzeti sa sledeće internet stranice www.kosovotelecom.com.

Prijavu i detaljnu poslovnu biografiju, motivaciono pismo, dokaze o stručnoj spremi i Uverenje, izdato od nadležnog suda (sa rokom važenja od 6 meseci), da se protiv kandidata ne vodi krivični postupak kao i potpisano pismenu Izjavu pod Zakletvom (koju mozete preuzeti sa internet stranice www.kosovotelecom.com), treba dostaviti lično u zatvorenoj koverti u kancelariji Glavne arhive (br. 6), sprat VI, Glavna zgrada TK-a, naselje Dardania, 10000 Priština, Republika Kosovo.

Pisma preporuka se ne zahtevaju u ovoj fazi postupka.

Kandidati/kinje koji/e podnesu nepotpunu ili neadekvatnu prijavu i dokumentaciju biće odbijeni.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Adnan Curri shpall te pavlefshme deftesen e Sh.F.M.U "Ilaz Thaqi" Hani Elezit.

► Bardha Bytyqi Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Vullnet Berisha Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të SH.M. të mjekësisë "Hysni Zajmi" ,Gjakovë.

► Skyfer Haxhija Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike " Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Pesëdhjetë e dy ditë pa më të dashurin tonë



Sokol Demaku

U bënë pesëdhjetë e dy ditë, pa babin dhe gjyshin tonë të dashur Sokol Demaku. Dhimbja dhe malli për ty assesi nuk ka të ndalur. Ike atëherë kur ne kishin ende nevojë për ty.

Do të kujtojmë përherë, udhërrëfyesi jonë, baba Sokol!

Me mall te kujton vajza; Xhemile Isufi me familjen e ngushtë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

